

PROJEKT-LIGJ “PËR KËSHILLIN FISKAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e Këshillit Fiskal në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj synon të kontribuojë në forcimin e disiplinës fiskale, rritjen e transparencës dhe garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Këshilli Fiskal” është Këshilli Fiskal i Shqipërisë, një institucion i pavarur i krijuar në përputhje me këtë ligj, përgjegjës për monitorimin e politikës fiskale dhe për të kontribuar në disiplinën fiskale, transparencën dhe qëndrueshmërinë e financave publike.
2. “Parimet dhe rregullat fiskale” janë kufizime numerike dhe procedurale që rregullojnë politikën fiskale, të përcaktuara në nenin 4/1 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfshirë kufijtë e borxhit, objektivat e deficitit buxhetor, tavanet e shpenzimeve dhe çdo rregull tjetër fiskal të parashikuar në legjislacionin në fuqi;
3. “Ligji Organik i Buxhetit” është ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
4. “Plani i shpenzimeve neto” nënkupton trajektoren shumëvjeçare të rritjes së shpenzimeve primare neto, e cila përcaktohet nga Këshilli i Bashkimit Evropian pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
5. “Qëndrueshmëria e financave publike” është aftësia e qeverisë për të ruajtur politikat aktuale të shpenzimeve, të të ardhurave tatimore dhe të politikave të tjera, pa rrezikuar aftësinë paguese ose pa shkaktuar mospërbushje të detyrimeve apo shpenzimeve të angazhuara.

6. “Njësitë e Qeverisjes së përgjithshme” janë tërësia e njërive të qeverisjes qendrore, vetëqeverisjes vendore dhe të fondeve speciale, sipas përcaktimeve të Sistemit Evropian të Llogarive (ESA).
7. “Rreziqet fiskale” janë faktorë që mund të shkaktojnë devijime të rezultateve fiskale nga parashikimet, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, goditjet makroekonomike, detyrime të kushtëzuara si dhe rreziqe që lidhen me zbatimin e politikave.
8. “Buxheti vjetor” është tërësia e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të Buxhetit të Shtetit, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë për një vit fiskal të vetëm.
9. “Vendimi i Këshillit të Ministrave mbi Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal Afatmesëm (VKM mbi KMFA)” është raporti mbi vlerësimet dhe parashikimet makroekonomike dhe buxhetore, sipas dispozitave të nenit 23 të Ligjit Organik të Buxhetit.
10. “Njësi publike” është çdo njësi që bën pjesë në qeverisjen e përgjithshme ose kontrollohet prej saj;
11. “Konflikti i interesave” është çdo situatë në të cilën interesat private të një anëtari mund të ndikojnë ose të perceptohen se ndikojnë në ushtrimin e paanshëm dhe objektiv të detyrave të tij.

Neni 3

Statusi Ligjor

Këshilli Fiskal është institucion i pavarur, që i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Këshilli Fiskal është person juridik dhe raporton drejtëpërdrejt pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Këshilli Fiskal ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të pavarur nga çdo institucion tjetër publik apo subjekt privat dhe nuk i nënshtohet asnjë forme ndikimi në ushtrimin e funksioneve të tij.

Neni 4

Fusha e veprimtarisë

Këshilli Fiskal monitoron zbatimin e parimeve, rregullave dhe kufizimeve fiskale të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit, vlerëson zhvillimet në politikën fiskale dhe jep opinione të pavarura mbi qëndrueshmërinë e financave publike si dhe rreziqet ndaj saj.

KAPITULLI II

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KËSHILLIT FISKAL

Neni 5

Detyrat e Këshillit Fiskal

Këshilli Fiskal përgatit analiza dhe jep opinione të pavarura, objektive dhe profesionale lidhur me:

1. zbatimin e parimeve dhe rregullave fiskale të parashikuara në nenin 4/1 të Ligjit Organik të Buxhetit, si dhe rreziqet e devijimit prej tyre;
2. zbatimin e dispozitave të paragrafëve 1 dhe 5 të nenit 4/2 të Ligjit Organik të Buxhetit, si dhe rreziqet e devijimit nga këto dispozita;
3. zbatimin e dispozitave të nenit 4/3 të Ligjit Organik të Buxhetit, si dhe rreziqet e devijimit nga këto dispozita;
4. ekzistencën dhe vlefshmërinë e rrethanave të jashtëzakonshme, sipas nenit 4/4 të Ligjit Organik të Buxhetit, të cilat kanë sjellë devijime të përkohshme nga zbatimi i parimeve dhe rregullave fiskale të përcaktuara në nenin 4/1;
5. Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal, sipas nenit 23 të Ligjit Organik të Buxhetit;
6. projektligjin për buxhetin vjetor, si dhe ndryshimet dhe rishikimet e tij të miratuara sipas procedurës parlamentare;
7. raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit dhe çdo dokument tjetër që i paraqitet Kuvendit ose publikohet në përputhje me ligjin organik të buxhetit;
8. rreziqet fiskale dhe probabilitetin për realizimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm;
9. përputhshmërinë, koherencën dhe efektivitetin e kuadrit kombëtar buxhetor, duke vlerësuar në veçanti përputhshmërinë ndërmjet objektivave fiskale, aftësinë e kuadrit për të arritur objektivat e politikës fiskale si dhe kontributin e procesit buxhetor në realizimin e këtyre objektivave;
10. faktorët që çojnë në devijimin nga trajektorja e shpenzimeve neto, e përcaktuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Analizat dhe opinionet e Këshillit Fiskal për çështjet e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të paragrafit 1 të këtij neni bashkëlidhen si pjesë përbërëse e dokumenteve që i dorëzohen Këshillit të Ministrave ose Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Ministria e Financave i vë në dispozicion Këshillit Fiskal dokumentacionin përkatës dhe materialet shoqëruese, përfshirë në formë elektronike të redaktueshme, përpara paraqitjes për miratim në Këshillin e Ministrave të projektligjit për buxhetin vjetor ose të projektvendimit për Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal.

Këshilli Fiskal paraqet opinionin e tij zyrtar për buxhetin vjetor ose për Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal pranë Ministrisë së Financave, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e dokumentacionit.

Kur opinionet e Këshillit Fiskal përmbajnë vërejtje, Ministria e Financave harton një relacion shpjegues, si pjesë përbërëse e dokumenteve që i paraqiten Këshillit të Ministrave, duke argumentuar arsyet e mosmarrjes parasysh të tyre, sipas rastit. Ky relacion i paraqitet Kuvendit dhe publikohet.

Këshilli Fiskal, me nismën e tij, mund të përgatisë analiza dhe të japë opinione mbi efektet fiskale të projektligjeve të veçanta, mjaftueshmërinë e masave të ndërmarra gjatë periudhës së rregullimit si dhe çështje të tjera në fushën e politikës fiskale dhe menaxhimit të financave publike.

Me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose Kuvendit, Këshilli Fiskal mund të kryejë veprimtaritë e parashikuara në paragrafin 6 të këtij neni, me kusht që të vlerësojë se ka përmbushur detyrimet e tij sipas paragrafit 1 të këtij neni, të ketë kapacitetin institucional të nevojshëm dhe të mos ekzistojnë pengesa të arsyeshme.

Me ftesë, Këshilli Fiskal merr pjesë në seanca dëgjimore dhe diskutime në Kuvend.

KAPITULLI III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE TË KËSHILLIT FISKAL

Neni 6

Struktura dhe mandati i Këshillit Fiskal

Këshilli Fiskal përbëhet nga 3 (tre) anëtarë.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Fiskal është 6 (gjashtë) vjet, me të drejtë riemërimi vetëm një herë.

Anëtarët e Këshillit Fiskal ushtrojnë funksionin e tyre me kohë të plotë.

Për ushtrimin e detyrës, anëtarët e Këshillit Fiskal përfitojnë pagë mujore. Kryetari i Këshillit Fiskal përfiton pagë mujore të barasvlershme me pagën e Ministrit, ndërsa anëtarët e tjerë përfitojnë pagë mujore të barasvlershme në masën 85 përqind të pagës së Kryetarit.

Në ushtrimin e funksioneve të tyre, anëtarët e Këshillit Fiskal veprojnë në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe autonome, duke respektuar standardet më të larta profesionale dhe etike. Ata nuk marrin pjesë në veprimtari politike dhe nuk shprehin publikisht bindjet politike.

Neni 7

Procedura e Emërimit të Anëtarëve të Këshillit Fiskal

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Fiskal, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat shpall një thirrje publike për përzgjedhjen e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj.

Thirrja publike, e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, qëndron e hapur për jo më pak se 30 ditë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare, në të paktën një media të shtypit kombëtar, si dhe në faqen zyrtare të Kuvendit.

Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, pas përfundimit të afatit të aplikimit, verifikon dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve nga kandidatët dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe në thirrjen publike. Komisioni zhvillon një intervistë publike me kandidatët e përzgjedhur dhe mbi këtë bazë, i propozon Kuvendit 3 (tre) kandidatë për emërim si anëtarë të Këshillit Fiskal.

Anëtarët e Këshillit Fiskal emërohen nga Kuvendi me shumicë votash prej më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Në rast se asnjëri prej kandidatëve të propozuar nuk merr shumicën e kërkuar për emërim, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat shpall menjëherë një thirrje të re publike për paraqitjen e kandidaturave.

Jo më vonë se gjashtë muaj përpara përfundimit të mandatit të një anëtari të Këshillit Fiskal, Kryetari i Këshillit Fiskal njofton Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat për përfundimin e mandatit përkatës.

Pas marrjes së njoftimit, Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat fillon menjëherë procedurën për përzgjedhjen dhe emërimin e një anëtari të ri, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Kriteret kryesore për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Fiskal

Anëtarët e Këshillit Fiskal duhet të përmbushin standarde të larta të integritetit profesional dhe etik. Ata nuk mund të mbajnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, funksione politike, të jenë anëtarë të partive politike apo të ushtrojnë veprimtari që mund të krijojnë ndikim politik ose konflikt interesi. Anëtarët ushtrojnë detyrën e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme në vlerësimin profesional.

Anëtarët e Këshillit Fiskal nuk duhet të kenë ushtruar funksione politike, të kenë qenë pjesë e organeve drejtuese të një partie politike, apo të kenë qenë të punësuar në administratën publike gjatë 2 (dy) viteve para emërimit të tyre.

Anëtarët duhet të zotërojnë diplomë universitare të nivelit Master ose Doktoraturë në ekonomi, financa publike, makroekonomi, ekonometri, statistikë, financë ose fusha të tjera të lidhura ngushtë me to.

Anëtarët duhet të kenë të paktën 10 (dhjetë) vite përvojë profesionale të provuar në fushën e financave publike, makroekonomisë ose kërkimit shkencor në fushën e ekonomisë.

Neni 9

Përfundimi i mandatit dhe procedura e shkarkimit

Mandati i një anëtari të Këshillit Fiskal përfundon në rastet e mëposhtme:

1. me përfundimin e afatit të mandatit;
2. në rast vdekjeje;
3. në rast dorëheqjeje, e cila paraqitet me shkrim të paktën një muaj përpara datës kur kërkohet të hyjë në fuqi;
4. në rast shkarkimi.

Anëtari i Këshillit Fiskal shkarkohet nga detyra në rastet kur:

1. nuk plotëson një ose më shumë nga kriteret për emërim, të parashikuara në nenin 9 të këtij ligji;
2. nuk vepron në përputhje me këtë ligj ose me Kushtetutën gjatë ushtrimit të detyrës;
3. është i paaftë për të ushtruar detyrën për shkak të gjendjes fizike ose mendore për një periudhë që tejkalon tre muaj;
4. nuk ushtron detyrën për një periudhë të pandërprerë prej të paktën dy muajsh;
5. ka humbur zotësinë e plotë për të vepruar.

Vendimi për shkarkimin e një anëtari të Këshillit Fiskal merret nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, sipas të njëjtës procedurë të parashikuar për emërimin, pasi këtij të fundit i paraqitet me shkrim një propozim i arsyetuar për shkarkim nga anëtarët e tjerë të Këshillit Fiskal.

Pozicioni vakant në Këshillin Fiskal plotësohet jo më vonë se 90 ditë nga krijimi i tij, nëpërmjet emërimit të një anëtari të ri me mandat gjashtëvjeçar, sipas procedurave të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji.

Neni 10

Kryetari i Këshillit Fiskal

Anëtarët e Këshillit Fiskal zgjedhin ndërmjet tyre Kryetarin e Këshillit Fiskal.

Kryetari zgjidhet nga anëtarët e Këshillit Fiskal për një mandat 2-vjeçar, mbi bazë rotacioni. Rendi i rotacionit përcaktohet me short në mbledhjen e parë të Këshillit Fiskal, përveç rasteve kur një anëtar heq dorë vullnetarisht nga e drejta për të ushtruar funksionin e Kryetarit.

Kryetari i Këshillit Fiskal ka këto kompetenca:

1. përfaqëson, drejton dhe organizon veprimtarinë e Këshillit Fiskal;
2. thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Fiskal, si dhe përcakton rendin e ditës;
3. thërret dhe drejton mbledhjet e punës dhe ato profesionale të Këshillit Fiskal;
4. nënshkruan aktet e miratuara në mbledhjet e Këshillit Fiskal;
5. paraqet për dijeni pranë Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat projekt-rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Fiskal, si dhe projekt-akte të tjera në fushën e kompetencës së tij, përfshirë, sipas rastit, propozime për ndryshimin dhe plotësimin e tyre;
6. ndërmerr nisma dhe paraqet propozime e orientime në fushat që bëjnë pjesë në kompetencat e Këshillit Fiskal.

KAPITULLI IV SEKRETARIATI TEKNIK I KËSHILLIT FISKAL

Neni 11

Organizimi dhe funksionimi i Sekretariatit Teknik

Veprimtaria profesionale dhe teknike në mbështetje të Këshillit Fiskal kryhet nga Sekretariati Teknik i Këshillit Fiskal.

Sekretariati Teknik përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë me marrëdhënie pune të rregullt, të emëruar me kohë të plotë.

Anëtarët e Sekretariatit Teknik emërohen nga Këshilli Fiskal nëpërmjet një procedure konkurruese publike, mbi bazën e meritës, kualifikimeve profesionale dhe përshtatshmërisë për funksionin.

Anëtarët e Sekretariatit Teknik duhet të plotësojnë këto kriteret:

1. nuk mund të mbajnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, funksione politike, të jenë anëtarë të partive politike apo të ushtrojnë veprimtari që mund të krijojnë ndikim politik ose konflikt interesi.
2. Të kenë përfunduar studimet e ciklit të dytë (Master) në ekonomi, financa publike, makroekonomi, ekonometri, statistikë, financë ose fusha të tjera të lidhura ngushtë me to;
3. të kenë të paktën 7 (shtatë) vite përvojë profesionale të provuar në fushat e financave publike, makroekonomisë ose kërkimit shkencor në fushën e ekonomisë.

Niveli i pagës së anëtarëve të Sekretariatit Teknik është i barabartë me pagën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë.

KAPITULLI V

ORGANIZIMI DHE MËNYRA E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT FISKAL

Neni 12

Organizimi i mbledhjeve të Këshillit Fiskal

Këshilli Fiskal zhvillon mbledhje të rregullta në përputhje me rregulloren e tij.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Fiskal janë të detyruar të marrin pjesë rregullisht në mbledhje dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në përgatitjen dhe shqyrtimin e analizave, opinionëve dhe akteve të tjera që miratohen nga Këshilli Fiskal.

Mbledhjet e Këshillit Fiskal janë të vlefshme vetëm kur në to marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij.

Si rregull, mbledhjet e Këshillit Fiskal zhvillohen me dyer të mbyllura, me përjashtim të rasteve kur vetë Këshilli vendos që mbledhje të caktuara të jenë të hapura për publikun.

Në mbledhjet e Këshillit Fiskal marrin pjesë anëtarët e Sekretariatit Teknik, pa të drejtë vote.

Këshilli Fiskal mund të ftojë edhe persona të tjerë për të marrë pjesë në mbledhjet e tij, kur prania e tyre vlerësohet e nevojshme për shqyrtimin e çështjeve të veçanta të rendit të ditës.

Këshilli Fiskal miraton dhe publikon Programin Vjetor të Punës brenda datës 15 dhjetor të çdo viti, në të cilin përcaktohen veprimtaritë e planifikuara, produktet dhe afatet për vitin pasardhës. Këshilli Fiskal siguron kapacitetet e nevojshme për t'iu përgjigjur kërkesave urgjente për analiza nga Kuvendi, të cilat paraqiten nëpërmjet Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Zbatimi i Programit Vjetor të Punës raportohet në raportin vjetor të Këshillit Fiskal.

Neni 13

Vendimmarrja dhe procedurat e votimit

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Fiskal kanë të drejtën dhe detyrimin për të votuar mbi çdo propozim të paraqitur për vendimmarrje në mbledhjet e Këshillit Fiskal.

Vendimet e Këshillit Fiskal merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Anëtarët kanë detyrimin të votojnë dhe nuk lejohet abstenimi. Në rast barazie votash, vota e Kryetarit është vendimtare.

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Fiskal miratohet nga të gjithë anëtarët e tij me votim unanim dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit Fiskal.

KAPITULLI VI INFORMIMI PUBLIK DHE FINANCIMI

Neni 14

Mbështetja buxhetore dhe autonomia financiare

Fondet e nevojshme për funksionimin e Këshillit Fiskal, përfshirë shpenzimet operative dhe materiale, sigurohen nga Buxheti i Shtetit i Republikës së Shqipërisë, mbi bazën e kërkesave buxhetore të paraqitura nga Këshilli Fiskal.

Këshilli Fiskal paraqet kërkesën e tij buxhetore në përputhje me procedurat, mënyrën dhe afatet e përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Struktura organizative e Këshillit Fiskal miratohet me vendim të Kuvendit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për institucionet e pavarura.

Marrëdhëniet e punësimit rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Këshilli Fiskal gëzon autonomi të plotë në përdorimin dhe menaxhimin e fondeve të alokuara.

Këshilli Fiskal vepron në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

Veprimtaria financiare e Këshillit Fiskal i nënshtrohet auditimit të jashtëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 15

Transparenca dhe raportimi

Këshilli Fiskal paraqet në Kuvend një raport vjetor mbi veprimtarinë e tij, jo më vonë se fundi i muajit qershor të vitit aktual, për vitin kalendarik paraardhës.

Raporti vjetor përfshin, ndër të tjera, një aneks për matjen e performancës që përmban një përmbledhje statistikore të rezultateve të realizuara kundrejt atyre të planifikuara; vlerësimin e saktësisë së parashikimeve të Këshillit Fiskal; avancimi në objektivat strategjike dhe në nismat për përmirësim; si dhe çështje të tjera, sipas rregullores së brendshme ose me kërkesë të autoriteteve kompetente.

Këshilli Fiskal informon rregullisht publikun për veprimtarinë e tij, nëpërmjet konferencave për shtyp, takimeve informuese, deklaratave publike, publikimeve në faqen zyrtare dhe formave të tjera të përshtatshme të komunikimit.

Të gjitha analizat dhe opinionet e përgatitura nga Këshilli Fiskal publikohen në faqen e tij zyrtare të internetit, pa vonesa të pajustificuara.

Me kërkesë të mediave, analizat dhe opinionet e Këshillit Fiskal paraqiten nga Kryetari i Këshillit Fiskal ose nga një anëtar i autorizuar prej tij.

Në daljet publike sipas paragrafit 5 të këtij neni, anëtarët e Këshillit Fiskal janë të detyruar të paraqesin dhe të përfaqësojnë vetëm qëndrimet e miratuara në mbledhjet e Këshillit Fiskal.

Neni 16

Vlerësimi i jashtëm dhe siguria e cilësisë

Këshilli Fiskal i nënshtrohet, në mënyrë periodike, një vlerësimi të jashtëm gjithëpërfshirës, me qëllim vlerësimin e pavarësisë, efektivitetin dhe pajtueshmërinë e tij me mandatin ligjor.

Vlerësimi kryhet nga një panel i pavarur vlerësimi, i përbërë nga përfaqësues të institucioneve fiskale të pavarura të Bashkimit Evropian ose institucione të tjera ndërkombëtare të njohura, me ekspertizë përkatëse në këtë fushë.

Raporti i vlerësimit publikohet në faqen zyrtare të Këshillit Fiskal brenda 30 ditëve nga finalizimi i tij dhe i paraqitet Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe Komisionit Evropian. Brenda 60 ditëve nga publikimi i raportit të vlerësimit, Këshilli Fiskal harton një plan veprimi për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve, i cili bëhet publik. Progresi në zbatimin e planit të veprimit raportohet në raportet vjetore të Këshillit Fiskal.

Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat në Kuvend zhvillon seancë dëgjimore mbi gjetjet e raportit të vlerësimit dhe progresin në zbatimin e rekomandimeve, brenda 90 ditëve nga publikimi i tij.

KAPITULLI VII

BASHKËPUNIMI ME ORGANET E TJERA PUBLIKE DHE PERSONAT FIZIKË DHE JURIDIKË

Neni 17

Aksesi në informacion dhe bashkëpunimi

Për përgatitjen e analizave dhe opinioneve brenda mandatit të tij, Këshilli Fiskal ka të drejtë të aksesojë informacione dhe të dhëna që lidhen me fushën e veprimtarisë së tij, të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe të njësive të tjera publike në nivel qendror dhe vendor.

Të gjitha njësitë publike janë të detyruara të vënë në dispozicion informacionin dhe të dhënat e kërkuara, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, pasi të kenë marrë kërkesën nga Këshilli Fiskal. Të dhënat duhet të dorëzohen në format të redaktueshëm, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

Këshilli Fiskal ka të drejtë të bëjë publike rastet e njësive publike që nuk respektojnë detyrimet e parashikuara në këtë nen.

Këshilli Fiskal mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me institucionet që administrojnë statistikat zyrtare, njësitë e qeverisjes qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, njësitë e fondeve speciale dhe çdo ent tjetër publik në nivel qendror dhe vendor, si dhe me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, me qëllim sigurimin e aksesit në kohë në informacionin e nevojshëm për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të tij, si dhe për rregullimin e procedurave operacionale.

Këshilli Fiskal merr pjesë në aktivitetet e rrjeteve dhe organizatave evropiane e ndërkombëtare të institucioneve fiskale të pavarura dhe bashkëpunon me organe dhe organizata të tjera, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 18

Konfidencialiteti i informacionit

Anëtarët e Këshillit Fiskal, Sekretariati Teknik, punonjësit, ekspertët e jashtëm dhe çdo person tjetër i angazhuar nga Këshilli Fiskal janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni jopublik të marrë gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Informacioni konfidencial përdoret vetëm për qëllime të ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive të Këshillit Fiskal dhe nuk u vihet në dispozicion palëve të treta, përveç rasteve kur kërkohet me ligj.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pas përfundimit të mandatit, marrëdhënies së punës, marrëdhënies kontraktuale apo çdo forme tjetër angazhimi me Këshillin Fiskal.

Këshilli Fiskal miraton procedurat dhe masat e nevojshme për garantimin e mbrojtjes, ruajtjes dhe administrimit të informacionit konfidencial, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Dispozitat e këtij neni nuk pengojnë publikimin e opinioneve, raporteve, vlerësimeve dhe dokumenteve të tjera të miratuara nga Këshilli Fiskal në ushtrimin e mandatit të tij.

KAPITULLI VIII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 19

Afati për paraqitjen e propozimeve për anëtarët e Këshillit Fiskal

Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat ka detyrimin të propozojë në Kuvend anëtarët e Këshillit Fiskal brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Këshilli Fiskal konstituohet dhe fillon veprimtarinë e tij pasi të jenë zgjedhur të tre anëtarët.

Neni 20

Afatet për funksionimin e Këshillit Fiskal

Brenda 90 ditëve nga data e emërimit, Këshilli Fiskal shpall konkurs publik për përzgjedhjen e anëtarëve të Sekretariatit Teknik.

Brenda 60 ditëve nga data e emërimit, Këshilli Fiskal miraton rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tij.

Neni 21

Dispozita kalimtare

Organizmi i administratës publike përgjegjës për pasurinë shtetërore siguron, brenda 90 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, mjediset e përshtatshme të punës dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin e Këshillit Fiskal.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.